




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 19.01.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave për ri-shqyrtim të datës 15.01.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "AL-group" SHPK, si dhe kërkesa për ri-shqyrtim nga OE "Grand Bau" SHPK, "IPE Control-ING" SHPK, OE "Consult Engineering" SH.P.K., OE "SIB-BKA" SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Hartimi i projekteve të infrastrukturës Rrugë, kanalizim dhe shërbime gjeodezike**" me Nr. të Prok: 651-20-7907-2-1-1, mori këtë:

VENDIM

Aprovohen pjesërisht si të bazuar Kërkesat për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik "AL-Group", "Grand Bau" dhe IPE Control ING" SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Hartimi i projekteve të infrastrukturës Rrugë, kanalizim dhe shërbime gjeodezike**" me Nr. të Prok: 651-20-7907-2-1-1,, dhe


Njoftimi për Kontratë e AK-së, të datës 01.01.2021.

Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korigjimin e dosjes së tenderi, duke e korigjuar në harmoni me LPP dhe po ashtu do të vazhdohet afati i Hapjes së Ofertave .

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatorët ekonomik "AL-group" SHPK, si dhe kërkesa për ri-shqyrtim nga OE "Grand Bau" SHPK, "IPE Control-ING" SHPK, OE "Consult Engineering" SH.P.K., OE "SIB-BKA" SH.P.K, si palë e pakënaqur me datë 12/ dhe 15.01.2021 ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues të



Komunës së Gjilanit kundër Njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të infrastrukturës Rrugë, kanalizim dhe shërbime gjeodezike” me Nr. të Prok: 651-20-7907-2-1-1., dhe, me pretendimin se AK ka vepruar në kundërshtim të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të paraqitur në Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruesit, shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit dhe analizës konkrete në mënyrë të drejtë të gjitha fakteve dhe provave të administruara, gjeti dhe konstatoi se Kërkesat për Rishqyrtim të parashtruesve aprovohen si pjesërisht të bazuara.

Andaj AK duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit Po ashtu duke pasur në konsideratë nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së lidhur me mënyrën më efektive, transparente do të bejë korigjimin e dosjes së tenderit konformë rregullave të prokurimit dhe LPP.

Izet Kurteshi



Menaxher i zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës.

